

STATISTIKA TË KULTURËS

2025



STATISTIKA TË KULTURËS 2025

Drejtor botimi: **Dr. Lantona Sado**

Punoi: Elona Sevrani
Albana Berbiu
Deana Delaj
Isida Gorce

© Copyright INSTAT 2026


Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Kodi Postar 1017
Tel: + 355 4 2222411 / 2233356
Fax: +355 4 2222 411
e-mail: info@instat.gov.al
www.instat.gov.al

Dizajn: Adelajda Alla

STATISTIKA TË KULTURËS

2025



Përmbajtja

I. Hyrje	6
II. Pjesëmarrja në Kulturë	7
III. Trashëgimia kulturore	12
IV. Përdorimi i internetit për qëllime kulturore	15
V. Arsimi kulturor	19
VI. Punësimi në Kulturë	23
VII. Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit në Shërbime dhe Mallra Kulturorë	26
VIII. Shpenzimet Publike për Argëtim, Kulturë dhe Çështje Fetare	27
Shënime Metodologjike	28



I. HYRJE

INSTAT publikon të dhëna statistikore mbi kulturën, duke u fokusuar kryesisht në pjesëmarrjen kulturore të popullsisë dhe në dimensionin ekonomik të sektorit kulturor.

Treguesit e paraqitur përfshijnë pjesëmarrjen në aktivitete kulturore, trashëgiminë kulturore, si dhe aspektet e edukimit dhe punësimit në fushën e kulturës. Gjithashtu, seksione të veçanta i dedikohen edhe përdorimit të internetit për qëllime kulturore, indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit në shërbime dhe mallra kulturorë si dhe shpenzimeve publike për argëtim, kulturë dhe çështje fetare.

II. PJESËMARRJA NË KULTURË

Muzika, përmbajtjet audio-vizuale, performancat live dhe forma e tjera të shprehjes kulturore luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e vlerave të shoqërisë shqiptare, duke shërbyer njëkohësisht si mekanizma që forcojnë lidhjet sociale dhe ndërveprimin midis individëve dhe komunitetit. Pjesëmarrja në aktivitetet kulturore konsiderohet se ndikon në mënyrë të rëndësishme në cilësinë e jetës së individit, si dhe në mirëqenien e përgjithshme të shoqërisë.


Ky seksion paraqet të dhëna mbi pjesëmarrjen kulturore, të bazuara në anketën e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës që INSTAT zhvillon, si dhe në të dhëna administrative, të siguruar nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, të cilat përfshijnë numrin e aktiviteteve kulturore dhe pjesëmarrësve në këto aktivitete.

Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës mbledh të dhëna mbi pjesëmarrjen në aktivitete kulturore, me pagesë, për individët mbi 16 vjeç. Këto aktivitete përfshijnë vizitat në teatër, kinema, koncerte, aktivitete sportive etj.

Në vitin 2024, 41,8 % e individëve mbi 16 vjeç raportuan se morën pjesë rregullisht, në të paktën një aktivitet kulturor gjatë 12 muajve të fundit.

Për të treja vitet, vihet re që meshkujt kanë përqindje më të lartë të pjesëmarrjes në aktivitetet kulturore krahasuar me femrat. Në vitin 2024, morën pjesë rregullisht në aktivitete kulturore 42,4 % e meshkujve përkundjet 41,1 % e femrave.

Fig. 1 Pjesëmarrja në aktivitete kulturore për individët mbi 16 vjeç



Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës

*Rezultatet e anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës të vitit 2023 janë rivlerësuar bazuar në të dhënat e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023.

**Prej vitit 2024 dhe në vijim korniza e kampionimit dhe kalibrimi i rezultateve të anketës do të bazohet në Censin e Popullsisë dhe Banesave, 2023.



**VITI
2025**

**1.272 SHFAQJE
171.607 SPEKTATORË**

Të dhënat administrative nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit i referohen numrit të shfaqjeve dhe premierave të organizuara, gjatë vitit, nga institucionet qendrorë të artit, në varësi të Ministrisë së Kulturës.

Gjatë vitit 2025, janë organizuar gjithsej 1.272 shfaqje dhe premiera në institucionet qendrore të artit. Krahasuar me vitin e kaluar, numri i shfaqjeve dhe premierave ka pësuar rënie me 0,8 %. Në të njëjtën periudhë, në aktivitetet kulturore të organizuara nga institucionet qendrore të artit, morën pjesë 171.607 spektatorë, 36,2 % më pak, krahasuar me vitin 2024.

Tab. 1 Numri i shfaqjeve/premierave dhe spektatorëve në institucionet qendrore të artit

Shfaqje/premiera			INSTITUCIONE TË ARTIT	Spektatorë		
Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025		Viti 2023	Viti 2024	Viti 2025
147	142	158	Teatri Kombëtar Popullor	28.900	23.092	34.669
289	392	332	Teatri Kombëtar Eksperimental	20.220	22.975	22.124
300	317	248	Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor	55.852	56.185	48.600
209	179	190	Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	24.840	24.322	28.337
70	39	157	Cirku Kombëtar	12.748	122.920	25.210
15	10	32	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	-	-	-
145	203	155	Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit	10.481	19.415	12.667
1.175	1.282	1.272	Gjithsej	153.041	268.909	171.607

Burimi: Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit


Gjatë vitit 2025, u zhvilluan 314 aktivitete kulturore, me pjesëmarrje ndërkombëtare në Shqipëri, duke reflektuar intensifikimin e bashkëpunimeve artistike dhe kulturore me vende dhe institucione të ndryshme ndërkombëtare. Në aktivitetet kulturore ndërkombëtare morën pjesë gjithsej 261.654 pjesëmarrës.

Të dhënat tregojnë se Kosova, vendet e Bashkimit Evropian (EU) dhe Arabia Saudite realizuan numrin më të lartë të aktiviteteve kulturore, si edhe regjistruan nivelin më të lartë të pjesëmarrjes në këto veprimtari.

Përkatësisht, janë realizuar 59 aktivitete kulturore nga Kosova me 49.530 pjesëmarrës, 56 aktivitete nga vendet e Bashkimit Evropian me 31.250 pjesëmarrës dhe 36 aktivitete nga Arabia Saudite me 31.270 pjesëmarrës.



Fig. 2 Numri i aktiviteteve kulturore ndërkombëtare dhe numri i pjesëmarrësve, në Shqipëri, 2025




Burimi: Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, INSTAT



Pjesëmarrja e artistëve të huaj përbën një indikator të rëndësishëm të hapjes ndërkombëtare të sektorit kulturor shqiptar dhe të kapaciteteve organizative të institucioneve kulturore, për të tërhequr bashkëpunime artistike.

Në vitin 2025, numri i artistëve të huaj, të ardhur në Shqipëri, sipas vendit të origjinës, rezultoi 428. Arabia Saudite shënon praninë më të lartë të artistëve të huaj në aktivitetet kulturore në Shqipëri, me 29,7 % të totalit të artistëve të ardhur, e ndjekur nga Kosova (11,7 %), Italia (9,8 %) dhe Gjermania (6,8 %).

Fig. 3 Përqindja e artistëve të huaj të ardhur në Shqipëri, 2025



Burimi: Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, INSTAT

DITËT SHQIPTARE NË BOTË -CULTURALB


Lidhur me përfaqësimin e Shqipërisë në aktivitetet kulturore ndërkombëtare, projekti “Ditët Shqiptare në Botë -CulturAlb” ka luajtur një rol të rëndësishëm në promovimin e kulturës shqiptare jashtë vendit.

Gjatë vitit 2025 u realizuan 142 aktivitete kulturore dhe u angazhuan 885 artistë shqiptarë, duke kontribuar në prezantimin dhe forcimin e identitetit kulturor shqiptar në arenën ndërkombëtare.

Aktivitetet “Ditët Shqiptare në Botë - CulturAlb” u përqendruan kryesisht në Serbi (21,1 %) dhe Itali (19,0 %), të ndjekura nga Polonia (16,2 %) dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (13,4 %).



Fig. 4 Numri i aktiviteteteve në Ditët Shqipëtare në Botë - CulturAlb, 2025



Burimi: Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit

III. TRASHËGIMIA KULTURORE

Koncepti i trashëgimisë kulturore përfshin tërësinë e pasurive kulturore, të cilat shprehin vlerat, identitetin, njohuritë, traditat, besimet si dhe pasuritë kulturore të një shoqërie. Ajo përbëhet nga elemente të prekshme dhe të paprekshme, që së bashku formësojnë kujtesën historike dhe kulturore të një kombi.

Trashëgimia materiale përfshin monumente historike, muze, site arkeologjike, parqe kulturore dhe kala, ndërsa trashëgimia jomateriale përfshin elemente të paprekshme si muzika, vallëzimi, ritualet dhe traditat, të cilat transmetohen brez pas brezi dhe ruajnë vazhdimësinë kulturore. Në Listën e Pasurive Kulturore Botërore të mbrojtura nga UNESCO, Shqipëria është e përfaqësuar si nga trashëgimia materiale ashtu edhe nga ajo jomateriale (Tab. 2), duke reflektuar rëndësinë dhe diversitetin e trashëgimisë së saj kulturore.

Tab. 2 Pasuritë Kulturore të Shqipërisë të Mbrojtura nga UNESCO sipas Kategorive Materiale dhe Jomateriale

Trashëgimia botërore	Viti
Parku Kombëtar i Butrintit	1992
Qendra Historike e Gjirokastrës	2005
Qendra Historike e Beratit	2008
Lumi i Gashit	2017
Liqeni i Ohrit	2019
Trashëgimia kulturore jomateriale - Lista Përfaqësuese e Njerëzimit	Viti
Isopolifonia Popullore Shqiptare	2005
Transhumanca	2023
K'cimi i Tropojës	2024
Trashëgimia Kulturore Jomateriale në Nevojë të Mbrojtjes së Urgjencës	Viti
Xhubleta	2022
Arti i të luajturit, kënduarit dhe bërjes së lahutës	2025
Trashëgimia në Tentativë UNESCO	Viti
Amfiteatri i Durrësit	1996
Varret Mbretërore të Selcës së Poshtme	1996
Qyteti Antik i Apollonisë	1996
Kështjella e Bashkovës	2017

Burimi: UNESCO




Gjatë vitit 2025, në institucionet e trashëgimisë kulturore materiale, numri gjithsej i vizitorëve është 1.523.587, duke shënuar një rritje me 15,9 %, krahasuar me vitin 2024. Nga totali i vizitorëve, 66,0 % janë të huaj. Parqet Arkeologjike rezultojnë ndër pasuritë më të frekuentuara, duke tërhequr numrin më të lartë të vizitorëve si vendas ashtu edhe të huaj, krahasuar me kategoritë e tjera të trashëgimisë kulturore.

Tab. 3 Vizitorë në muze, kala dhe monumente të tjera, parqe arkeologjike

Trashëgimia kulturore	Viti 2024			Viti 2025		
	Të huaj	Vendas	Gjithsej	Të huaj	Vendas	Gjithsej
Muze	285.706	183.133	468.839	279.755	190.971	470.726
Kala e Monumente të tjera	239.310	105.475	344.785	310.791	116.419	427.210
Parqe Arkeologjike	263.254	238.121	501.375	415.387	210.264	625.651
Vizitorë gjithsej	788.270	526.729	1.314.999	1.005.933	517.654	1.523.587

Burimi: Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit

Fig. 5 Përqindja e vizitorëve të huaj në muze, kala dhe monumente të tjera, parqe arkeologjike



Burimi: Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, INSTAT

Tabela e mëposhtme paraqet muzetë, kalatë dhe parqet, në varësi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit si dhe frekuentimin në përqindje nga vizitorë vendas dhe të huaj, për secilin institucion.

Muzeu "Gjergj Kastrioti" rezulton muzeu më i frekuentuar (38,7 %), i ndjekur nga Muzeu Ikonografik "Onufri", Berat (21,7 %) dhe Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe" (16,6 %), ndaj totalit të vizitorëve në Muze.

Sa i përket kalave, Kalaja e Gjirokastrës ka tërhequr 71,9 % të vizitorëve, duke u renditur si një nga destinacionet më të vizituara të kësaj kategorie.

Ndër parqet arkeologjike dhe natyrore, më të frekuentuarit renditen Parku Kombëtar Butrint (47,2 %) dhe Parku Arkeologjik Shkodër (28,6 %).



Tab. 4 Frekuentimi në institucionet e trashëgimisë materiale, 2025 (%)

Institucione të trashëgimisë materiale	% e frekuentimit
Muze	
Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë*	-
Muzeu Arkeologjik, Durrës*	-
Muzeu i Pavarësië, Vlorë	5,0%
Muzeu Gjergj Kastrioti, Krujë	38,7%
Muzeu Etnografik, Krujë	6,5%
Muzeu Etnografik, Berat*	-
Muzeu Ikonografik Onufri, Berat	21,7%
Muzeu i Artit Mesjetar, Korçë	4,4%
Muzeu Arkeologjik, Korçë*	-
Muzeu i Arsimit, Korçë	2,8%
Muzeu Kombëtar i Fotografisë Marubi	4,3%
Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe"	16,6%
Vizitorë gjithsej në muze	470.726
Kala e Monumete të tjera	
Kalaja Gjirokastrë	71,9%
Kalaja e Portopalmos	11,2%
Kalaja e Kaninës	0,3%
Kalaja e Himarës	3,6%
Amfitetari Durrës	9,7%
Manastiri i 40 Shenjtorëve	0,7%
Torre Veneciane, Durrës	2,7%
Vizitorë gjithsej në kala	427.21
Parqe Arkeologjike	
Parku Kombëtar Butrint	47,2%
Parku Arkeologjik Apolloni	20,3%
Parku Arkeologjik Bylis	1,7%
Parku Arkeologjik Shkodër	28,6%
Parku Arkeologjik Lezhë	1,2%
Parku Arkeologjik Amantia	0,1%
Parku Arkeologjik Oriku	0,2%
Parku Arkeologjik Finiq	0,1%
Parku Arkeologjik Antigone	0,6%
Vizitorë gjithsej në parqe	625.651

Burimi: Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, INSTAT
 Shënim: Për hyrjen në këto institucione paguhet tarifë hyrëse.
 * Për hyrjen në këto institucione nuk paguhet tarifë hyrëse.

IV. PËRDORIMI I INTERNETIT PËR QËLLIME KULTURORE

Një pjesë e konsiderueshme e shoqërisë merr pjesë në aktivitete kulturore, përmes përdorimit të teknologjive moderne dhe internetit. Nëpërmjet anketës së përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në Familje dhe nga Individët, që INSTAT zhvillon, është matur përdorimi i rregullt i internetit nga personat 16-74 vjeç, për informacione ose aktivitete kulturore. Aktivitetet kulturore online përfshijnë pjesëmarrjen në rrjete sociale, leximin e gazetave, revistave në internet, komunikimin me mesazhe të shkurtra dhe blerjet online të librave, revistave, gazetave.

Të dhënat mbi përdorimin e internetit për qëllime kulturore janë fokusuar në frekuencën me të cilën individët kanë përdorur internetin gjatë tre muajve të fundit, për aktivitetet e mësipërme.

Përdorimi i internetit për qëllime kulturore

Në vitin 2025, përdorimi i internetit për qëllime kulturore gjatë tre muajve të fundit është rritur. 94,5% e njerëzve kanë përdorur mesazhe të shkruara për komunikim (si Skype, Messenger ose WhatsApp), ndërsa 85,7% kanë marrë pjesë në rrjetet sociale duke krijuar profile ose duke postuar. Në krahasim me këto dy aktivitete, 72,8% kanë lexuar gazeta dhe revista në internet. Këto shifra tregojnë se komunikimi përmes mesazheve dhe përdorimi i rrjeteve sociale janë më të përhapura se leximi i përmbajtjeve të lajmeve online.

Analizuar sipas nivelit arsimor, vihet re se për të gjitha kategoritë kulturore, individët 16-74 vjeç me arsim të lartë kanë përdorur më shumë internetin, për qëllime kulturore, sesa individët me një nivel më të ulët arsimor.

Tab. 5 Përdorimi i internetit për qëllime kulturore sipas nivelit arsimor (% e individëve mes individëve që përdorën internetin në tre muaj e fundit)

Viti	Kategoritë	Gjithsej	Arsimi i mesëm i ulët ose më pak	Arsimi i mesëm i lartë dhe pas të mesëm jo-i lartë	Arsim i lartë
2024	Leximi i lajmeve në gazeta, revista në internet	72,8	53,5	79,6	93
	Pjesëmarrja në rrjetet sociale (krijim profili duke postuar mesazhe ose aktivitete të tjera)	80	68,7	82,6	95,3
	Komunikimi me mesazhe të shkruara (Skype, Messenger apo WhatsApp)	92,4	85,6	95,1	98,9
2025	Leximi i lajmeve në gazeta, revista në internet	73,3	64,8	74,5	83
	Pjesëmarrja në rrjetet sociale (krijim profili duke postuar mesazhe ose aktivitete të tjera)	85,7	79,2	87,2	92,3
	Komunikimi me mesazhe të shkruara (Skype, Messenger apo WhatsApp)	94,5	91,4	95,3	97,3

Burimi: Anketa e përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në Familje dhe nga Individët, INSTAT


Analizuar sipas gjinisë, për çdo aktivitetet kulturor të kryer në internet, gjatë tre muajve të fundit, meshkujt regjistrojnë përqindjet më të larta të përdorimit të internetit për qëllime kulturore, me përjashtim të aktivitetit 'Blerje online e librave, revistave, gazetave', ku femrat rezultojnë si përdorueset më frekvente të internetit.

Tab. 6 Përdorimi i internetit për qëllime kulturore, sipas gjinisë, (në %)

Përdorimi i TIK për qëllime kulturore	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
Pjesëmarrja në rrjetet sociale (krijim profili duke postuar mesazhe ose aktivitete të tjera)	52,1	47,9	51,2	48,8	50,6	49,4
Komunikimi me mesazhe të shkruara (Skype, Messenger apo WhatsApp)	50,8	49,2	50,1	49,9	49,9	50,1
Leximi i lajmeve në gazeta, revista në internet	52,8	47,2	52,2	47,8	51,1	48,9
Blerje online e librave, revistave, gazetave	46,4	53,6	41,6	58,4	36,0	64,0

Burimi: Anketa e përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në Familje dhe nga Individët

Fig. 6 Përdorimi i internetit për qëllime kulturore sipas grupmoshës, 2025 (në %)



Burimi: Anketa e përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në Familje dhe nga Individët

Dallimet në aktivitetet kulturore sipas grupmoshave

Tabela paraqet përdorimin e internetit për aktivitete kulturore online, sipas grupmoshës, gjinisë dhe llojit të aktivitetit për vitin 2025. Grupmosha 16-24 vjeç rezultoi të jetë më aktive në përdorimin e internetit, për të gjitha format e aktiviteteve kulturore online, krahasuar me grupmoshat e tjera. Përdorimi i internetit për “filma apo seriale të shërbimeve të ndara apo të shkarkuara” është veçanërisht i lartë te të rinjtë (80,3 %), ndërsa bie ndjeshëm te grupmosha 55-74 vjeç (21,5 %). Po ashtu, për aktivitetin “e-libra, gazeta online apo revista online”, grupmosha 16-24 vjeç (44,0 %) shfaq përdorim më të lartë krahasuar me grupmoshën 55-74 vjeç (19,2 %). Ndërkohë, për aktivitetin “aplikacione në lidhje me shëndetin apo ushtrime fizike”, grupmosha 55-74 vjeç shfaq përdorim më të lartë, 24,2 %.

Sipas gjinisë, rezultatet tregojnë se përdorimi i internetit për aktivitete kulturore online është relativisht i ngjashëm mes meshkujve dhe femrave, me ndryshime më të dukshme tek “Lojra online ose të shkarkuara për telefona smart, tableta, kompjuter apo play station”, ku meshkujt kanë përqindje më të lartë përdorimi (42,8 %), ndërsa femrat shfaqin përdorim më të lartë për “Filma apo seriale të shërbimeve të ndara apo të shkarkuara” (41,6 %).

Tab. 7 Përdorimi i internetit për qëllime kulturore sipas grupmoshës dhe gjinisë (% e individëve mes individëve që përdorën internetin në tre muaj e fundit)

2025		Muzikë apo shërbime të ndara apo të shkarkuara	Filma apo seriale të shërbimeve të ndara apo të shkarkuara	E-libra gazeta online apo revista online	Lojra online ose të shkarkuara për telefona smart tableta kompjuter apo play station	Aplikacione në lidhje me shëndetin apo për ushtrime fizike (përfshirë aplikacionet falas)
Gjithsej		36,7	41,8	25,8	40,8	20,8
Grup-mosha	16-24	75,6	80,3	44,0	71,5	21,6
	25-54	20,6	26,0	18,1	28,7	20,1
	55-74	18,3	21,5	19,2	19,1	24,2
Gjinia	Meshkuj	37,2	41,9	24,5	42,8	19,7
	Femra	36,4	41,6	26,9	39,2	21,7

Burimi: Anketa e përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në Familje dhe nga Individët, INSTAT

Përdorimi i internetit për blerjen e mallrave dhe shërbimeve kulturore

Një mjet alternativ për të analizuar pjesëmarrjen kulturore, përmes anketës së përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, është studimi i përqindjes së njerëzve, që përdorin internetin në tre muajt e fundit, për të blerë mallra dhe shërbime kulturore.



36,7 % e individëve 16-74 vjeç e kanë përdorur internetin për blerje online 'Bileta për evente kulturore dhe sportive' dhe 'Bileta për evente kulturore apo të tjera (kinema, koncert, panaire etj)', 34,3 % për 'Të mira dhe mallra sportive (Përfshijë rroba sportive)', 13,0 % kanë kryer blerje online për 'Libra, gazeta dhe revista' dhe 11,6 % për 'Filma dhe muzikë'.

Në përgjithësi, janë meshkujt ato që e përdorin më shumë internetin për blerje online, model që vihet re dhe te shërbimet kulturore lidhur me kategoritë 'Të mira dhe mallra sportive (përfshijë rroba sportive)' dhe 'Filma dhe muzikë'. Ndërkohë, për kategorinë kategoria 'Bileta për evente kulturore apo të tjera (kinema, koncert, panaire etj)', dominojnë femrat.

Të rinjtë e grupmoshës 16-24 vjeç e kanë përdorur më shumë internetin për blerje online të 'Biletave për evente kulturore dhe sportive', ndërkohë grupmosha 25-54 vjeç e ka përdorur më shumë internetin për 'Bileta për evente kulturore apo të tjera (kinema, koncert, panaire etj)'.

Tab. 8 Përdorimi i internetit për blerje online, 2025

(% e individëve mes individëve që përdorën internetin në tre muajt e fundit)

2025		Bileta për evente (përfshirë evente sportive)	Libra, revista, gazeta	Filma, muzikë	Te mira dhe mallra sportive (përfshijë rroba sportive)	Bileta për evente kulturore apo të tjera (kinema, koncert, panaire etj.)
Gjithsej		36,7	13,0	11,6	34,3	36,7
Grup-mosha	16-24	48,2	8,7	8,8	32,4	39,7
	25-54	31,3	14,0	12,3	33,9	34,3
	55-74	38,6	23,9	18,1	49,9	48,2
Gjinia	Meshkuj	39,7	10,5	11,7	37,7	31,3
	Femra	34,3	14,9	11,4	31,7	38,6

Burimi: Anketa e përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në Familje dhe nga Individët, INSTAT

V. ARSIMI KULTUROR

Arsimi në kulturë paraqet informacion statistikor të fokusuar në dy drejtime kryesore që lidhin arsimin me dimensionin kulturor. Pjesa e parë përfshin të dhëna mbi regjistrimet e studentëve në arsimin e lartë, në fusha studimi të lidhura me kulturën, ndërsa pjesa e dytë fokusohet në shkëmbimin kulturor përmes studentëve të huaj, që ndjekin studimet në universitetet shqiptare.

Të dhënat, janë me burim administrativ dhe janë siguruar nga Ministria e Arsimit. Klasifikimi i fushave të studimit bazohet në standardin ndërkombëtar ISCED-F 2013, sipas të cilit fushat e konsideruara të lidhura me kulturën janë: “Arte”, “Shkenca Humane dhe Gjuhët”, “Gazetari dhe Informim”, “Arkitekturë dhe Ndërtim” dhe “Sporte”.

Arsimi i lartë në fushat e lidhura me kulturën

Në vitin akademik 2025-2026, në fushat e studimit të lidhura me kulturën, janë regjistruar gjithsej 16.111 studentë, 3,2 % më pak, krahasuar me vitin e kaluar akademik. Të dhënat tregojnë se, afërsisht një në shtatë studentë, ndjek studime në programe të lidhura me kulturën.

Ndër fushat e studimit të lidhura me kulturën, “Arkitekturë dhe Ndërtim” rezulton fusha më e preferuar nga studentët, duke përbërë 38,0 % të totalit të regjistrimeve në këto fusha. Ajo pasohet nga fusha “Sporte”, me 19,4 % të studentëve të regjistruar. Këto të dhëna tregojnë një interes të lartë të studentëve për programe studimi që kombinojnë dimensionin krijues, profesional dhe praktik.

Tab. 9 Studentë të regjistruar në arsimin e lartë në fushat e studimit të lidhura me kulturën

FUSHA	2023-2024	2024-2025	2025-2026
Arte	2.214	2.288	2.355
Humanitare	1.285	1.228	1.088
Gjuhët	3.795	3.381	3.019
Gazetari dhe informim	557	512	406
Arkitekturë dhe ndërtim	5.972	6.246	6.119
Sporte	2.892	2.990	3.124
Gjithsej	16.715	16.645	16.111

Burimi: Ministria e Arsimit, INSTAT
 Shënim: Të dhënat e arsimit të lartë nuk janë përfundimtare, për regjistrimet në programet e studimit Doktoraturë dhe Specializime Afatgjata, për vitin 2025-26.

Fig. 7 Studentë gjithsej të regjistruar në arsimin e lartë në fushat e studimit të lidhura me kulturën




Burimi: Ministria e Arsimit, INSTAT

Shënim: Të dhënat e arsimit të lartë nuk janë përfundimtare, për regjistrimet në programet e studimit Doktoraturë dhe Specializime Afatgjata, për vitin 2025-26.

Në fushat e studimit të lidhura me kulturën, femrat përbëjnë shumicën e studentëve me 56,1%. Përqindja e femrave është më e lartë në fushat “Gjuhët” (82,4%), “Gazetari dhe informim” (75,1%) dhe “Shkenca humane” (69,8%) dhe më e ulët në fushën “Sporte”, ku femrat përbëjnë 24,0% të studentëve në këtë fushë.

Fig. 8 Përqindja e studentëve të regjistruar në fushat e kulturës sipas gjinisë, 2025-2026



Burimi: Ministria e Arsimit, INSTAT

Shënim: Të dhënat e arsimit të lartë nuk janë përfundimtare, për regjistrimet në programet e studimit Doktoraturë dhe Specializime Afatgjata, për vitin 2025-26.

Shkëmbimi kulturor në arsimin e lartë

Shkëmbimi kulturor në arsimin e lartë, përkufizohet si kalimi fizik i kufijve kombëtarë, nga vendi i origjinës drejt një vendi tjetër, me qëllim ndjekjen e studimeve dhe pjesëmarrjen në aktivitete që lidhen me arsimin e lartë në vendin pritës. Ky koncept përfshin studentët që zgjedhin të zhvillojnë një pjesë ose të gjithë ciklin e studimeve të tyre, jashtë vendit të origjinës. Studimi jashtë vendit të origjinës u ofron studentëve mundësinë të njihen me sisteme të ndryshme arsimore, të fitojnë përvoja të reja akademike dhe kulturore, si dhe të zhvillojnë aftësi ndërkulturore dhe profesionale. Në të njëjtën kohë, prania e studentëve të huaj kontribuon në rritjen e shkëmbimeve akademike dhe kulturore, duke forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe diversitetin në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri.

Ky seksion paraqet të dhëna vetëm për studentët e huaj, të regjistruar në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri. Të dhënat synojnë të evidentojnë nivelin e ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë, në vend dhe rolin e Shqipërisë si vend pritës për studentët ndërkombëtarë.

Në vitin akademik 2025-2026, studentët e huaj përbënin 2,1 % të totalit të studentëve të regjistruar në arsimin e lartë në Shqipëri. Krahasuar me vitin akademik 2024-2025, pesha e studentëve të huaj është rritur me 0,3 pikë përqindjeje, duke treguar një rritje të interesit të studentëve ndërkombëtarë për të ndjekur studimet në institucionet shqiptare të arsimit të lartë.

Për të tre vitet e fundit akademik, studentët e huaj, meshkuj, dominojnë krahasuar me studentet e huaja femra. Shumica e studentëve të huaj të regjistruar në arsimin e lartë në Shqipëri vijnë nga Italia, të cilët përbëjnë 45,9 % të totalit të studentëve të huaj, ndjekur nga studentët nga Kosova me 11,9 %.

Tab. 10 Studentë të huaj të regjistruar në arsimin e lartë

Viti	Femra	Meshkuj	Total
2023-24	1,7%	2,2%	1,9%
2024-25	1,6%	2,2%	1,8%
2025-26	1,7%	2,5%	2,1%

Burimi: Ministria e Arsimit, INSTAT

Shënim: Të dhënat e arsimit të lartë nuk janë përfundimtare, për regjistrimet në programet e studimit Doktoraturë dhe Specializime Afatgjata, për vitin 2025-26.





Fig. 9 Përqindja e studentëve të huaj të regjistruar në arsimin e lartë, sipas vendit të origjinës, 2025-26




Burimi: Ministria e Arsimit, INSTAT

Shënim: Të dhënat e arsimit të lartë nuk janë përfundimtare, për regjistrimet në programet e studimit Doktoraturë dhe Specializime Afatgjata, për vitin 2025-26.

Pjesa më e madhe e studentëve të huaj janë të regjistruar në programet e studimit Bachelor dhe Master, duke treguar interesin më të lartë për ciklet kryesore të arsimit të lartë në Shqipëri.

Sipas gjinisë, studentët meshkuj të huaj dominojnë në programet Bachelor dhe në studimet e Doktoraturës, ndërsa në programet dyvjeçare profesionale dhe në programet Master, vihet re një pjesëmarrje më e lartë e studenteve femra të huaja. Këto dallime pasqyrojnë prirje të ndryshme në zgjedhjen e programeve të studimit, sipas gjinisë dhe nivelit të arsimit të lartë.

Fig. 10 Përqindja e studentëve të huaj të regjistruar në nivelet e arsimit të lartë sipas gjinisë, 2025-26




Burimi: Ministria e Arsimit, INSTAT

Shënim: Të dhënat e arsimit të lartë nuk janë përfundimtare, për regjistrimet në programet e studimit Doktoraturë dhe Specializime Afatgjata, për vitin 2025-26.

VI. PUNËSIMI NË KULTURË

Informacioni mbi punësimin në kulturë është siguruar nga Anketa e Forcave të Punës dhe pasqyron numrin e individëve të punësuar të moshës 15 vjeç e lart, sipas aktiviteteve ekonomike dhe profesioneve të cilat lidhen me fushën e kulturës.

Në vitin 2025, në aktivitete ose profesione të lidhura me kulturën janë të punësuar 33.893 individë, të cilët përbëjnë 3,0 % të punësimit gjithsej. Krahasur me vitin e kaluar, punësimi në kulturë pësoi një rritje me 0,1 pikë përqindje. Sipas gjinisë, pjesa më e madhe e të punësuarve në kulturë janë meshkuj, të cilët përbëjnë 62,8 % të totalit të punësimit kulturor në vitin 2025. Kjo përqindje është rritur me 8,4 pikë përqindje krahasuar me vitin e mëparshëm.



Tab. 11 Punësimi në kulturë
Burimi: Anketa e Forcave të Punës





Fig. 11 Punësimi në kulturë sipas gjinisë, (në %)




Burimi: Anketa e Forcave të Punës, INSTAT

Përqindja e femrave të punësuar në sektorin kulturor rezulton më e ulët, krahasuar me peshën që ato zënë në punësimin total të ekonomisë, ku përfaqësojnë 37,2 % të të punësuarve gjithsej.

Ndërkohë, të rinjtë e grupmoshës 15-29 vjeç, të cilët përbëjnë vetëm 15,4 % të punësimit total në vend, kanë një përfaqësim relativisht më të lartë në sektorin kulturor, duke zënë 25,1 % të punësimit në kulturë në vitin 2025. Megjithatë, krahasuar me vitin paraardhës, kjo përqindje ka shënuar një rënie prej 4,0 pikë përqindje.

Fig. 12 Përqindja e të rinjve 15-29 vjeç në punësimin në kulturë dhe në punësimin gjithsej


• 2025 • 2024



Burimi: Anketa e Forcave të Punës, INSTAT

Të punësuarit me arsim të lartë përbëjnë pjesën më të madhe të punësimit në sektorin kulturor, duke zënë 68,3 % të totalit të të punësuarve në kulturë në vitin 2025. Ndërkohë, në strukturën e punësimit të përgjithshëm të ekonomisë, individët me arsim të lartë përbëjnë vetëm 23,4 % të të punësuarve gjithsej.

Fig. 13 Shpërndarja e punësimit gjithsej dhe punësimit në kulturë sipas nivelit arsimor, (në %)



Burimi: Anketa e Forcave të Punës

Në vitin 2025, numri i të punësuarve si artistë krijues dhe interpretues, autorë, gazetarë dhe gjuhëtarë në grupet ISCO 264 dhe 265, është rritur me 29.7 %, krahasuar me vitin 2024. Struktura e punësimit karakterizohet nga një nivel i lartë i angazhimit me orar të plotë dhe nga të punësuar vetëm me një punë. Ndërkohë numri i punonjësve me punë të përhershme është rritur vazhdimisht dhe ka arritur në 4.713 në vitin 2025, duke treguar një rritje të qëndrueshmërisë në këtë sektor.

Tab. 12 Të punësuar si autorë, gazetarë, gjuhëtarë dhe artistë krijues e interpretues

Punësimi në kulturë	2023	2024	2025
Autorë, gazetarë, gjuhëtarë dhe artistë krijues e interpretues (ISCO 264 & 265)			
Të punësuar	6.010	5.750	7.459
Persona të vetëpunësuar	3.429	2.610	2.746
Persona të punësuar me orar të plotë	5.528	5.304	6.851
Punonjës me punë të përhershme	2.466	3.140	4.713
Persona të punësuar vetëm me një punë	5.949	5.727	7.408

Burimi: Anketat e Forcave të Punës

Shënim: Treguesit nuk janë kategori përmblendhëse dhe nuk mbledhen me njëri-tjetrin. Ato paraqesin karakteristika të ndryshme të njëjtit grup personash.



VII. INDEKSI I HARMONIZUAR I ÇMIMEVE TË KONSUMIT, NË SHËRBIME DHE MALLRA KULTURORE

Niveli dhe struktura e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve janë një nga përcaktuesit kryesorë të shpenzimeve familjare. Kështu, informacioni mbi indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumit plotëson të dhënat për shpenzimet private për mallrat dhe shërbimet kulturore. Indeksi ofron informacion mujor për ndryshimet e çmimeve në shërbime dhe mallra kulturore, duke lehtësuar kështu monitorimin e rregullt.

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) mat ndryshimin e nivelit të çmimeve me pakicë të mallrave dhe shërbimeve të cilët konsiderohen kulturor nga pikëpamja e strukturës së shpenzimeve të cilat konsumatori (vendas dhe i huaj) synojnë për konsumin final në territorin e Shqipërisë.


Në vitin 2025, rritja më e lartë e çmimeve për mallrat dhe shërbimet kulturore është shënuar në kategorinë “Librat” me 2,9% dhe ulja më e lartë në kategorinë “Pajisje audio-vizuale, fotografike dhe riparimi i tyre” me 1,8%.

Tab. 13 Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit për disa mallra dhe shërbime kulturore
Viti bazë: Dhjetor 2015 = 100

Shërbime/Mallra Kulturore	Viti 2024	Viti 2025
Pajisje audio-vizuale, fotografike dhe riparimi i tyre	93.9	92.2
Instrumenta muzikore	153.4	151.4
Shërbime kulturore	110.7	110.4
Libra	127.0	130.7
Gazeta dhe periodikë të tjerë	104.0	104.2

Burimi: Anketa e Çmimeve të Konsumit

Fig. 14 Ndryshimi vjetor në përqindje i indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit për disa mallra dhe shërbime kulturore, 2025




Burimi: Anketa e Çmimeve të Konsumit

VIII. SHPENZIMET PUBLIKE PËR ARGËTIM, KULTURË DHE ÇËSHTJE FETARE

Ky seksion paraqet të dhëna në lidhje me shpenzimet publike për fushën Argëtim, Kulturë dhe Çështje Fetare. Këto shpenzime kanë një rol të rëndësishëm në mbështetjen, zhvillimin dhe promovimin e vlerave artistike, të artit dhe aktiviteteve kulturore, duke kontribuar në forcimin e identitetit kulturor dhe në prezantimin e kulturës shqiptare në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në 2025, shpenzimet publike për Argëtim, Kulturë dhe Çështje Fetare përbëjnë 1,65 % të shpenzimeve publike gjithsej dhe zënë një peshë prej 0,50 % në PBB-në gjithsej. Krahasuar me vitin 2024, shpenzimet publike për Argëtim, Kulturë dhe Çështje Fetare shprehur si përqindje ndaj PBB-së janë rritur me 0,05 pikë përqindje, ndërsa në përqindje ndaj totalit të shpenzimeve publike janë rritur me 0,09 pikë përqindje.

Fig. 15 Shpenzimet publike për argëtim, kulturë dhe çështje fetare, (në %)



Burimi: Ministria e Financave, INSTAT

* Të dhënat janë gjysëm-finale

** Të dhënat janë bazuar në vlerësimet tremujore

SHËNIME METODOLOGJIKE

Statistikat e paraqitura në këtë publikim janë siguruar nga anketat që INSTAT zhvillon dhe nga burimet administrative si Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministria e Arsimit, si dhe Ministria e Financave. Metodologjia e përdorur bazohet në rekomandimet e Eurostat.



Pjesëmarrja kulturore

Përfshin të dhëna bazuar në anketën e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës që INSTAT zhvillon dhe në të dhënat administrative, të siguruar nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit lidhur me numrin e aktiviteteve kulturore dhe numrin e pjesëmarrësve në aktivitetet kulturore.

Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës mbledh të dhëna për pjesëmarrjen në aktivitete kulturore me pagesë të individëve mbi 16 vjeç, sipas gjinisë. Aktivitetet kulturore përfshijnë vizitat në teatër, kinema, koncerte, aktivitete sportive etj.

Në institucionet qendrore të artit e të kulturës përfshihen: Cirku Kombëtar, Teatri Eksperimental, Teatri Kombëtar, Teatri i Operas, Baletit dhe Ansambli Popullor, Qendra Kombëtare e Kinematografisë, Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, Biblioteka Kombëtare, Galeria Kombëtare e Arteve, Qendra Kombëtare e Librit dhe leximit.



Trashëgimia kulturore

Të dhënat mbi trashëgiminë kulturore i referohen muzeve, kalave dhe parqeve arkeologjike, të cilat janë në varësi të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit. Institucionet e trashëgimisë kulturore përfshijnë institucionet:

Muze	Kala e monumente të tjerë	Park arkeologjik
Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë	Kalaja Berat	Parku Kombëtar, Butrint
Muzeu Arkeologjik, Durrës	Kalaja Gjirokastër	Parku Arkeologjik, Apolloni
Muzeu i Pavarësisë, Vlorë	Kalaja e Portopalermos	Parku Arkeologjik, Bylis
Muzeu Gjergj Kastrioti, Krujë	Kalaja e Kaninës	Parku Arkeologjik, Shkodër
Muzeu Etnografik, Krujë	Kalaja e Himarës	Parku Arkeologjik, Lezhë
Muzeu Etnografik, Berat	Amfiteatri Durrës	Parku Arkeologjik, Amantia
Muzeu Ikonografik Onufri, Berat	Manastiri i 40 Shenjtorëve	Parku Arkeologjik, Orikum
Muzeu i Artit Mesjetar, Korçë	Torre Veneciane, Durrës	Parku Arkeologjik, Finiq
Muzeu Arkeologjik, Korçë		Parku Arkeologjik, Antigone
Muzeu i Arsimit, Korçë		
Muzeu Kombëtar i Fotografisë Marubi		
Muzeu Kombëtar i Përgjimeve "Shtëpia me Gjethe"		

Arsimi kulturor

Të dhënat mbi regjistrimet e studentëve në arsimin e lartë në fusha studimi të lidhura me kulturën janë siguruar nga Ministria e Arsimit. Arsimi kulturor pasqyron gjithashtu të dhëna për shkëmbimin kulturor, duke u fokusuar te studentët e huaj që studiojnë në Universitetet Shqiptare. Bazuar në klasifikimin e fushave të studimit (ISCED-F 2013), fushat që konsiderohen të lidhura me kulturën janë:



Fushat në kulturë

- 021 Arte
- 022 Shkenca humane
- 023 Gjuhët
- 032 Gazetari dhe informim
- 073 Arkitekturë dhe ndërtim
- 1014 Sporte

Punësimi në kulturë

Të dhënat mbi punësimin në kulturë bazohen në Anketën e Forcave të Punës së Shqipërisë, të dhëna vjetore dhe mbulojnë popullsinë 15 vjeç e lart. Punësimi kulturor përfshin të gjithë personat që punojnë në aktivitete ekonomike që konsiderohen të jenë kulturore, pavarësisht nëse personi është i punësuar në një profesion kulturor. Ai gjithashtu mbulon personat me një profesion kulturor, pavarësisht nëse ata janë të punësuar në një aktivitet ekonomik jo-kulturor. Përkufizimi i punësimit kulturor përcaktohet në terma të Klasifikimit Statistikor të Aktiviteteve Ekonomike në Komunitetin Evropian (NACE Rev. 2) dhe Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Profesioneve (ISCO-08). Një listë e plotë e aktiviteteve ekonomike dhe profesioneve që janë përdorur për të përcaktuar punësimin kulturor është dhënë më poshtë:



Sektorët Kulturorë (aktivitetet ekonomike) — NACE Rev. 2

- 18 Shtypja dhe riprodhimi i mediave të regjistruara
- 32.2 Prodhimi i instrumenteve muzikore
- 58.1 Botimi i librave, revistave periodike dhe veprimtari të tjera botuese
- 59 Aktivitete të prodhimit të programeve filmike, video dhe televizive, regjistrim të zërit dhe muzikës
- 60 Aktivitete programuese dhe transmetuese
- 74.1 Aktivitete të specializuara të dizajnit
- 74.2 Aktivitete fotografike
- 74.3 Aktivitetet e përkthimit dhe interpretimit
- 90 Aktivitete krijuese, artistike dhe argëtuese
- 91 Biblioteka, arkiva, muze dhe veprimtari të tjera kulturore

Profesionet kulturore — ISCO-08

216 Arkitektë, planifikues, topografë dhe dizajnerë

2353 Mësues të tjerë të gjuhës

2354 Mësues të tjerë të muzikës

2355 Mësues të tjerë të arteve

262 Bibliotekarë, arkivistë dhe kuratorë

264 Autorë, gazetarë dhe gjuhëtarë

265 Artistë krijues dhe interpretues

3431 Fotografë

3432 Dizenjues dhe dekorues të brendshëm

3433 Teknikë të galerisë, muzeut dhe bibliotekës

3435 Profesionistë të tjerë të asociuar artistikë dhe kulturorë

3521 Teknikë transmetimi dhe audio-vizualë

4411 Nëpunës të bibliotekës

7312 Prodhues dhe akordues të instrumenteve muzikore

7313 Punëtorë të stolive dhe metaleve të çmuar

7314 Poçarë dhe punëtorë të ngjashëm

7315 Prodhues të qelqit, prerës, bluarës dhe ilustrues

7316 Shkrimtarë shenjash, piktorë dekorativë, gdhendës dhe të tjerë

7317 Punëtorë artizanalë në dru, shporta dhe materiale të ngjashme

7318 Punëtorë artizanalë në tekstil, lëkurë dhe materiale të ngjashme

7319 Punëtorë artizanalë të pa klasifikuar diku tjetër



Përkufizimi i fushës/shtrirjes së punësimit kulturor – shembuj

Punësimi		Aktivitetet ekonomike (NACE Rev.2)	
Profesionet (ISCO-08)		Kulturore	Jo-Kulturore
	Kulturore	Kërcimtar në një kompani baleti	Dizenjator në një industri automobilash
	Jo-Kulturore	Financier në një shtëpi botuese	



Përdorimi i internetit për qëllime kulturore

Të dhënat mbi përdorimin e rregullt të internetit (3 muajt e fundit) nga individët 16-74 vjeç janë siguruar nga anketa e përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në Familje dhe nga Individët, që INSTAT zhvillon me periodicitet vjetor.

Aktivitet online kulturore përfshijnë pjesëmarrjen në rrjete sociale, leximi i gazetave, revistave në internet, komunikimi me mesazhe të shkurtra dhe blerjet online të librave, revistave, gazetave.

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit



Të dhënat mbi indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumit lidhur me mallrat dhe shërbimet kulturore janë siguruar nëpërmjet anketës të Çmimeve të Konsumit, që INSTAT zhvillon me periodicitet mujor. Ky tregues bazohet në Klasifikimin Europian të Shpenzimeve Individuale sipas Qëllimit (ECOICOP) me 12 ndarje kryesore.

ECOICOP –qëllime kulturore

CP091 Pajisje audio-vizuale, fotografike dhe riparimi i tyre

CP09221 Instrumenta muzikore

CP0942 Shërbime kulturore

CP0951 Libra

CP0952 Gazeta,dhe mjete shkollore

Shpenzimet Publike për Argëtim, Kulturë dhe Çështje Fetare



Të dhënat mbi shpenzimet publike për fushën e kulturës janë siguruar nga INSTAT dhe Ministria e Financave.



Përkufizime

Trashëgimia kulturore është tërësia e pasurive kulturore, materiale dhe jomateriale, të një individi, grupi ose shoqërie të trashëguara nga e kaluara që ruhen në të tashmen, për t'ua përçarë brezave në të ardhmen, si pjesë e pasurisë kombëtare të një vendi, të cilat shprehin vlerat, identitetin, njohuritë, traditat, besimet si dhe pasuritë kulturore.

Muze është institucioni i ruajtjes së kujtesës, në shërbim të shoqërisë dhe zhvillimit të saj, i hapur për publikun, që konservon, studion, komunikon dhe prezanton trashëgiminë e luajtshme e të paluajtshme të njerëzimit dhe mjedisit rrethues të tij, me qëllim edukimin, studimin, promovimin dhe argëtimin.

Monument kulture është objekti ose ndërtimi me vlera historiko-kulturore, që mbrohet nga shteti.

Park arkeologjik është territori i përcaktuar me kufij të qartë, që përfshin dëshmi të rëndësishme arkeologjike të mbitokës, nëntokës e nënujit dhe bashkëprani të pasurive historike, peizazhit kulturor, i organizuar me elemente të një muzeu në natyrë.

Blerjet "online" i referohen porosive të mallrave ose shërbimeve nëpërmjet internetit, blerjeve të tyre nëpërmjet internetit (e-blerje) për qëllime personale nëpërmjet çdo lloji pajisjeje (desktop, i lëvizshëm ose i dorës, përfshirë telefonin celular ose telefon smart).

STATISTIKA TË KULTURËS

2025